

Titulli	Aplikim per Leje per Zhvillimet transformuese në territor (rrugë, autostrada, aeroporte, porte, vepra industriale, qendra të reja banimi, vepra të tjera, si edhe për çdo transformim të territorit, duke përfshirë projektet minerare, në pronësi shtetërore ose private)
Përshkrimi i shkurtër i shërbimit (1-2 fjali)	Shqyrtim në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale i projekteve zhvillimore transformuese në territor
Kontakt	Sekretaria Teknike
Viti	2020
Tage kërkimi (të ndara me presje)	Projekt zhvillimor, projekt per zhvillimet transformuese, KKTKM
Kategoria e shërbimit	Dokumente dhe Certifikata
Ministria (zgjidhni ministrinë në varësi të së cilës është institucioni juaj)	Ministria e Kulturës
Institucioni	
Tip shërbimi	Per qytetare, biznese dhe qeveritar
Niveli i shërbimit Për info referojuni linkut	1
Përshkrimi i gjatë (i detajuar i shërbimit, i cili duhet të përfshijë edhe bazën ligjore)	Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Neni 134 dhe V.K.M. nr. 208, datë 10.04.2019 “Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve Të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, projektet, në rastet e zhvillimeve të mëdha, si: rrugë, autostrada, aeroporte, porte, vepra industriale, qendra të reja banimi, vepra të tjera, si edhe për çdo transformim të territorit, duke përfshirë projektet minerare, në pronësi shtetërore ose private, përpara marrjes së lejes përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, investitori duhet të marrë miratimin për projektin nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, sipas legjislacionit në fuqi. Kategoritë e projekteve zhvillimore transformuese: • centralet prodhuese të energjisë, • impiantet e prodhimit dhe të përpunimit të gazit, naftës e bitumeve, naftësjellësit dhe gazsjellësit, depot e naftës, gazit dhe derivateve të naftës • impiantet e trajtimit dhe strukturat e depozitimit të mbetjeve, të ngurta dhe të lëngshme

	• aeroportet, portet • korpuset universitare, komplekset spitalore, sportive, zbavitjeje, stadione, etj; • qendra të reja banimi, komplekse rezidenciale, resorte dhe fshatra turistike tradicionale, • muzetë dhe teatrot kombëtarë; • minierat, kriporet, karrierat, pika nxjerrjeje dhe shfrytëzimi inertesh; • strukturat dhe infrastrukturat ushtarake sipas legjislacionit të posaçëm; • Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut; • strukturat dhe qendrat e prodhimit e të përpunimit të industrisë metalurgjike, farmaceutike, kimike, armëve, lëndëve plasëse apo teknologjisë së lartë; • qendrat apo institucionet në të cilat kryhen veprimtari, përfshirë kërkimore dhe eksperimentale në fusha të industrisë kimike, fizikës bërthamore dhe të tjera; • rrjeti apo sisteme të infrastrukturave kombëtare • strukturat dhe rrjetet e furnizimit me ujë, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave; • pikat e furnizimit me karburant; • investimet strategjike.
Dokumentacioni i nevojshëm	Dokumente shoqëruese 1. Formulari i Aplikimit Online -Të dhënat për Aplikuesin -Të dhëna për Projektuesin Restaurator (emër/mbiemër/numër licencë) - Lloji i Lejes për të cilën aplikohet -Te dhëna mbi Projektin -Te dhëna mbi zhvilluesin e projektit - Te dhëna mbi pronesinë 2. Mandat Paguesa 3. Deklarate Noteriale / Autorizim nga zhvilluesi për aplikantin (në rastin kur aplikanti nuk është zhvillues i projektit) 4. Lejet, licensat, autorizimet apo aktet e miratimit të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit të posaçëm 5. Deklarate përgjegjësie profesionale të projektuesve Dokumente nga aplikanti 1. Raport i Vezhimit arkeologjik i firmosur nga person fizik/juridik me licensë përkatëse në arkeologji 2. Projektet teknike dhe relacionet përkatëse, në formatin pdf dhe i nënshkruar nga personi fizik/juridik i licensuar sipas legjislacionit; (Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e azhurnuar të hartës së parcelës_ave; Vendndodhja me koordinata gjeografike; Ortofoto; Specifikime Teknike). 3. Grafiku i Punimeve

	4. Preventiv 5. Prezantim Projekti ne poëerpoint 6. VNM (per Hec-et specifikisht)
Hapat e procedurës	Hapat e procedurës nëse i gjithë dokumentacioni është i plotë 1. Aplikimi pranë IKTK-se (e-leje); 2. Shqyrtim nga Sekretaria Teknike për dokumentacion; 3. Shpërndarja nëpër drejtori dhe në DRTK-në ku shtrihet projekti; 4. Shqyrtimi në Këshill Teknike; 5. Shqyrtim në KKTKM dhe nxjerrja e Vendimit; 6. Shpërndarja e Vendimit.
Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit	45 ditë, në rastet e nevojshme për verifikim të natyrës teknike afati është 60 ditë
Periudha e vlefshmërisë së shërbimit (psh certifikatës së dhënë etj.)	Sipas grafikut të punimeve të depozituar
Kostot për marrjen e shërbimit	Në proces miratimi të kostove të shërbimit
Të tjera (orari i hapjes etj.)	Orari i shqyrtimit të kërkesave: E hënë – E enjte 8:00 – 16:30 E premte 8:00 – 14:000